

PËRDORIMI I SHPREHJEVE TË HUAZUARA NË GJUHËN SHQIPE DHE HARTIMI I NJË FJALORI PËR TO

ALI JASHARI

Universiteti "FAN S.NOLI", KORÇË, SHQIPËRI

Gjuhëtari i madh zviceran, Ferdinand de Saussure, ka thënë se gjuha është si një lumë që rrjedh pashkëputur. E tillë është edhe gjuha jonë amtare. Ajo ka rrjedhur qysh nga arbërit, është zhdërvilluar dhe pasuruar ndër shekuj, duke u mbrujtur me fjalët dhe shprehjet më të bukura të popullit dhe ka bërë të vetat përkryerjet e njerëzve më të shquar të penës të kombit tonë.

E, në këtë rrjedhë të furishme, nuk ka mënuar "të huajë" edhe gjëra të spikatura nga simotrat e saj, fjalë e shprehje të bukura që, me kalimin e kohës, nuk e ndiejnë veten keq në "shtratin" e lumit të shqipërisë.

Ndër ato që kanë gjetur vend fort bukur në mjedisin tonë gjuhësor dhe kulturor janë edhe kalket, huazimet frazeologjike, fjalët e urta dhe proverbat, si dhe thënie të njerëzve të shquar (që do t'i përmbledhim nën termin "shprehje të huazuara"), të cilat, shpesh, duke kaluar nga një gjuhë në tjetrën, kanë mbetur anonime.

Duke studiuar këtë realitet gjuhësor, shprehjet e huazuara nuk duhet të vështrohen si "mish i huaj" në trupin e shqipërisë, por pjesë e saj si gjuhë kulturore, si shenjë e marrëdhënies të ndërsjellëta në kulturat e popujve të ndryshëm dhe si shprehje konkrete e përngritjes kulturore të popullit shqiptar.

Popujt, sot e gjithë kohën, kanë përfituar nga kultura e njëri-tjetrit. Në këtë kuptim, hyrja dhe përdorimi i shprehjeve të huazuara është një dukuri që haset në të gjithë kombet e zhvilluar. Edhe në gjuhën shqipe kjo është një dukuri e vënë re prej kohësh. Kush ka lexuar letërsinë dhe publicistikën e paraçlirimit, nuk ka se si të mos e ketë pikasur këtë. Por, veçanërisht vitet e fundit, si rrjedhojë e hapjes së vendit tonë ndaj botës, falë edhe etjes së madhe të njerëzve tanë për të mësuar gjuhë të tjera dhe për të ditur sa më shumë nga kultura botërore, në gjuhën shqipe ka një prurje të madhe të këtyre shprehjeve.

I. Përmbledhja e kalkeve¹ dhe e huazimeve frazeologjike², aq të pasura dhe të larmishme, në një fjalor shpjegues dhe me shembuj ilustrues të përzgjedhur, ka qenë një dëshirë dhe një ndjenjë detyre prej shumë vitesh.

Ky thesar gjuhësor-stilistik i begatshëm i jep ligjërimin të shkruar një forcë e bukuri të veçantë, prandaj, dora-dorës, ia hymë kësaj pune për ta vjelë atë nga veprat e botuara dhe pastaj për ta sistemuar, sipas parimesh e kriteresh të pranuar tashmë në vija të përgjithshme nga leksikografia jonë, në trajtën e një fjalori³.

Ç'e bën të nevojshëm hartimin e një fjalori të tillë? Është natyrisht veçantia e lëndës gjuhësore që përmban, jo thjesht se përbëhet nga shprehje e jo nga fjalë, ose se është edhe në gjuhën shqipe e në gjuhë të huaja. Është ajo arsye që i bën të përdoren shpesh në ligjërimin e shkruar e të folur: përmbajtja e ngjeshur si "esenca" e lëndëve të ndryshme, por që nuk ka nevojë të hollohet. E, meqë e nisëm krahasimin me "esencën" e lëndëve të tjera. Kjo "esencë" ka dalë nga "kullimi" i ngjarjeve historike, i ndodhive të fabulave e të legjendave, i mendimeve dhe i vepri-
meve të moralshme e të pamoralshme, i përfundimeve prekëse në jetë e në legjendë. Nën këto shprehje mbulohen histori të vërteta e të trilluara, që folësi i sotëm edhe mund të mos i dijë, por domethënien e tyre e merr me shprehjet që kanë mbijetuar. Dhe ato kanë mbijetuar sepse sjellin deri sot histori

të mëdha, jo nga përmasat e ngjarjeve, por nga vlerat morale, nga mësimet për jetën e për sjelljen, nga përvoja e çmuar që na e japin shkurt e qartë. Kështu, ato përmbajnë një këshillë, që të veprosh a të mos e pësosh si ka ndodhur dikur diku. Kjo sintezë e brendshme e përmbajtjes vjen si një mesazh nga shekujt e nga mijëvjeçarët, por i fuqizuar shi për shkallën e lartë të sintezës dhe të lashtësisë së pavdekshme. Prandaj i kanë quajtur "perla të gjuhës", si nga shkëlqimi e nga qëndrueshmëria, ashtu edhe nga vlerat shumë të çmueshme që kanë. Bash për këto vlera shumëkush që i di ndien vetiu nevojën që t'i shtjerë në ligjëratën e tij, por gjithnjë në një mënyrë të veçantë, me një vlerësim të veçantë, që i kapërcen mjetet e tjera të shprehjes, i trajton, të themi, si "mikështa" të nderuara, kur, në të vërtetë, janë mjete që i vijnë në ndihmë me saktësinë e me forcën e tyre. Mirëpo, që të jenë të tilla, duhen njohur mirë e duhen përdorur drejt.

Në parathënien e këtij fjalori, akademiku Jani Thomai ka shkruar se shumë nga këto shprehje, të përkthyer a sikurse në gjuhë të huaj, dalin në shtyp, në letërsinë e përkthyer etj., por ato dalin më shpesh në fjalime, diskutime, debate, intervista e biseda të tjera, sidomos rreth çështjeve politike, ekonomike e shoqërore. Kur nuk dihet kuptimi i vërtetë i këtyre shprehjeve, keqpërdoren vend e pa vend ose tjetër për tjetër, madje deri në një mënyrë qesharake, kur "guri i Sizifit"

Shprehjet e huazuara në gjuhën shqipe dhe hartimi i një fjalori për to

shndërrohet në “guri i Josifit”. Këto janë shprehje të ligjërimin libror e në ligjërimin libror shprehen intelektualet, pushtetarët, politikanët, deputetët, gazetarët, shkrimtarët, shkencëtarët e njerëzit e kulturës. Atyre që nuk i dinë mirë këto shprehje, u vihet në dorë ky fjalor, me formën e me kuptimin e saktë, me historinë e krijimit të tyre (me “etimologjinë”) e me shembuj të zgjedhur të përdorimit, që shërbejnë si gjedhë.

Meqë janë rrjedhoja të ngjarjeve e të bëmave të njerëzve, përgjithësisht përmbajnë në vetvete a të shprehur gjuhësisht një krahasim, i cili i lidh me të tashmen, me situatën tonë ligjëri-more, veçse krahasimi bëhet me një ngjarje, dukuri, veprim a vetje aq madhore, sa ka mbijetuar deri sot. Edhe fare pak shembuj nga fillimi i fjalorit janë të mjaftueshëm: (si) *filli i Arianës*, (si) *shtyllat herkuliane*, (si) *nyjë gordiane*, (si) *ankthi i Abrahamit*, (si) *arka e Noes*, (si) *balonë prove*, (si) *barkë shpëtimi*, (si) *betimi i Hanibalit* etj. Një pjesë e shprehjeve kanë trajtën e një-sive frazeologjike, të fjalëve të urta a janë proverbializuar: *analogjia nuk është argument*, *i lëshoi (i dorëzoi, i hodhi, i uli) armët, artileri e rëndë, besimi lëviz malet* etj.

Përdoruesi i këtij fjalori do të gjejë aty tri të dhëna me rëndësi: përveç shprehjeve në shqipe a në gjuhë të huaja që i duhen në ligjërimin e tij dhe kuptimin e vlerat e tjera të këtyre shprehjeve, do të gjejë edhe motivimin e këtyre shprehjeve nëpërmjet përshkrimit të

ngjarjeve, të dukurive, të veprimeve a të vetjeve nga kanë dalë këto shprehje. Kjo i shërben përdoruesit të fjalorit jo vetëm për ta rrokur më mirë kuptimin e saktë të shprehjeve, që do t’i shërbejë për ngulitjen në kujtesë përgjithnjë e për t’i përdorur si duhet, po do të përfitojë kulturë historike, shoqërore e morale duke njohur pikërisht ato ngjarje, dukuri, veprime e vetje; fjala vjen, do të mësojë se ç’bëri Herkuli për të pastruar hauret e Augjisë (sipas mitologjisë), kur e ku është përdorur për herë të parë shprehja (*u shit*) për *tridhjetë aspra*, kush quhej *avokati i djallit* në Mesjetë, ç’bënte Karoni me barkën e tij, pse Apoloni i vuri Midiasit veshë gomari, ç’bëri babai kur iu këthe në shtëpi biri plangprishës e shumë e shumë histori të tjera të mençura e të bukura. Nga ky fjalor përdoruesi do të mësojë e do të ndiejë njëherazi kënaqësi estetike.

Për të hartuar një fjalor të tillë u volën shprehje të huazuara të përdorura në letërsinë e shkruar në mbi 430 vepër, prej rreth 310 autorësh (rreth 160 mijë faqe), si dhe ato të përdorura në median e shkruar, nga u nxorën afër 32000 skeda që regjistrojnë (pa marrë parasysh përsëritjet) rreth 3000 kalke dhe huazime frazeologjike, proverba e fjalë të urta.

Për të hartuar kriteret praktike të këtij fjalori shfrytëzuam arritjet e leksikografisë shqiptare, studimet në fushën e frazeologjisë shqipe, si dhe traditën e gjuhësisë së huaj në harti-

min e fjalorëve me kalke dhe huazime frazeologjike.

Një referim i dobishëm ishte “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” (1980) ku frazeologjia është pasqyruar mjaft e plotë. Por botimi i “Fjalorit frazeologjik të gjuhës shqipe” nga prof.dr. Jani Thomai, u bë një mbështetje e madhe për fjalorin e shprehjeve të huazuara në gjuhën shqipe, sepse ai është një përmbledhje e plotë e frazeologjisë shqipe sipas parimesh dhe kriteresh të sakta shkencore, si dhe në të jepet një pjesë e mirë e kalkeve frazeologjike që përdoren në gjuhën shqipe.⁴

Fjalori me shprehje të huazuara është i tipit shpjegues filologjik me përbërës enciklopedikë. Ai përfshin, sikurse e përmendëm më lart, rreth 3000 njësi të tilla, si dhe mjaft proverba e shprehje të tjera idiomatike.

Fjalori me shprehje të huazuara në gjuhën shqipe përbëhet nga dy pjesë: në pjesën e parë të titulluar “Filli i Arianës” përfshihen kalket frazeologjike, ndërsa në pjesën e dytë të titulluar “Paris vaut bien le messe”, jepen huazimet frazeologjike.

Fjalori synon të plotësojë disa qëllime:

a) Të pasqyrojë në mënyrë sa më të plotë shtresën e shprehjeve të huazuara që përdoren në gjuhën shqipe, sidomos në ligjërimin e shkruar.

b) Të nxjerrë në pah vlerat kuptimore-stilistike dhe risitë e përdorimit të këtyre shprehjeve në kontekstet e shqipes së shkruar nga autorë të ndryshëm,

për ta bërë sa më të qartë përmbajtjen.

c) Të përhapë te një masë sa më të gjerë lexuesish këtë pasuri të madhe të kulturës botërore.

ç) Të ndihmojë lexuesit për përdorimin e drejtë të tyre në ligjërim, për shkak se kuptimi i një pjese të madhe të shprehjeve të huazuara nuk njihet ose është i paqartë dhe, në këto raste, nuk është gjithnjë e lehtë të zbulosh kuptimin e tyre vetëm nga konteksti, prandaj lind nevoja t’u drejtohesh fjalorëve të kësaj natyre. Duhet thënë që te ne, në mjaft raste, në të folur dhe në të shkruar, sikurse u përmend dhe pak më lart, ka keqpërdorime të këtyre shprehjeve për shkak të mosnjohjes, ose teprime për shkak të një farë “sno-bizmi” gjuhësor. Fjalori do t’i ndihmojë të gjithë ata që duan të përdorin shprehje të tilla, jo vetëm me kuptimin e vërtetë të tyre, por edhe në formën e saktë, me lidhjet (valencat) sintaksore normative, me situatat ligjërimore e stilet funksionale ku përshtaten etj.

d) Të hedhë në “qarkullim” shprehje të huazuara të papërdorura ende në ligjërimin e shkruar, me qëllim që të pasurohet edhe më shumë fjalori i lexuesve.

II. Vështirësia e parë për hartuesin e një fjalori të tillë është përcaktimi i një-sive nëse janë kalke ose janë të vetë shqipes, pra se çfarë vëllimi do të ketë ky fjalor. Kjo vështirësi shtohet se mund të ketë krijime tipologjike të njëjta, por të pavarura, ose se mjaft kalke frazeo-

logjike, duke u përdorur dendur, nuk ndihen më si të tilla në shqip, madje kanë hyrë edhe në ligjërimin popullor. Megjithatë, ka disa tregues të mirëfilltë që përcaktojnë se këto shprehje janë kalkuar nga gjuhë të tjera.

Së pari, ato përdoren në gjuhën shqipe edhe si kalke, edhe si huazime frazeologjike, si *fakt i kryer* - fr. *fait accompli*; *balonë prove* - fr. *ballon d'essai*; *rreth i mbyllur* - lat. *circulus citiosus*; *bukë dhe lodra* - lat. *panem et circem*; *të rrosh a të mos rrosh, kjo është çështja* - angl. *to be or not to be, that is question*; *kusht i domosdoshëm* - lat. *conditio sine qua non*; *në mesin e gjërave* - lat. *in medias res*; *mënyrë jetese* - lat. *modus vivendi*; *tokë e panjohur* - lat. *terra incognita*; *argumenti i fundit* - lat. *ultima ratio* etj. Madje, edhe kur hasen në formën pa përkthim, ato ndihen se janë të kalkuara për shkak të natyrës leksiko-semantike të gjymtyrëve, të lidhjeve sintagmatike të tyre etj., si: *gomë shpëtimi*; *patate përveçuese*; *grusht i hekurt*; *gur prove*; *gjueti shtrigash*; *mollë e ndaluar*; *heshtje që flet*; *hedh hije*; *ironia e fatit*; *bën ligjin*; *hyri në histori*; *jakat e bardha*; *lot krokodili*; *i vesh këmbësh në forcës*; *kënga e mjellmës*; *luftë e ftohtë*; *maja e ajsbergut*; *i bën apologjinë* etj.

Së dyti, siç vë në dukje prof. Jani Thomai, kalket frazeologjike janë përkthyer fjalë për fjalë nga gjuha burimore dhe gjenden si të tilla në shumë gjuhë të botës, si: *vras kohën*: fr. *tuer le temps*; angl. *kill time*; *lexoj midis rreshtave*: angl. *read between the lines*; fr. *lire entres les lignes*; *avokati i djallit*: lat. *advoca-*

tus diaboli; angl. *a devil's advocate*; fr. *l'avocat du diable*; *mollë sherri*: gr. *millontis eridhos*; lat. *malum discordiae*; angl. *the apple of discord*; fr. *pomme de discorde*; rus. *яблоко радора*; gjerm. *der Apfel der Zëietracht*; ital. *pomo della discordia*; *mesi i artë*: lat. *aurea mediocritas*; angl. *the golden mean*; frëngj. *juste milieu* etj.; *mollë e ndaluar*: angl. *the forbidden fruit*; fr. *le fruit défendue*; *pomme défendue*; rus. *запретный плод*; *fitore si e Pirros*: angl. *a Pyrrich victory*; fr. *la victoire a la Pyrrhus*; gjerm. *Pyrrhussieg*; ital. *la vittoria di Pirro*; rus. *Pirrova pobeda*; spanj. *victoria Pirrica* etj.

Së treti, vetë kontekstet ku përdoren këto shprehje e përligjin natyrën e tyre të kalkuar. Siç vumë në dukje më lart, ato përdoren në letërsinë politiko-shoqërore e shkencore, prandaj edhe në shumë fjalorë shënohen me shkurtimin *libr.* (të gjuhës librore). Një ndihmë e madhe për këtë kanë qenë fjalorët dygjuhësh apo fjalorët e hartuar në gjuhë të tjera për kalket dhe huazimet frazeologjike.

Së katërti, shumica e kalkeve frazeologjike kanë edhe tregues të përveçëm, si emra vendesh, personash a personazhesh etj., që nuk i përkasin botës shqiptare, si *kaloj Rubikonin*; *varka e Noes*; *filli i Arianës*; *Roma nuk u bë (nuk u ndërtua) në një ditë*; *shumë zhurmë për asgjë*; *edhe ti, Brut*; *ose Cezar, ose asgjë*; *dashuri platonike*; *ëndrra amerikane*; *nyje gordiane*; *muri i Berlinit*; *feneri i Diogjenit* etj.

Në përcaktimin e njëmendësisë së

shprehjeve të huazuara shërbejnë edhe burimet e tyre, të cilat janë të mjafta:

a) me prejardhje biblike, si: *alfa dhe omega; ankthi i Abrahamit; Ardha e Dytë; arnë e rë mbi rrobë të vjetër; u shit për tridhjetë aspra; biri (djali) plangprishës; buka e përditshme; t'i japim Cezarit atë që është e Cezarit dhe Perëndisë atë që është e Perëndisë; i lau duart (si Pilati); çorbë e prishur; damka e Kainit; dashi i kurbanit; ndan delen nga cjeptë; dënim egjiptian; bën diellin dhe shiun; të bëhet drita; mbodhi dhëmbët e dragoit; ndaj egjrën nga gruri; engjëlli mbrojtës; kush mbjell erën, korr furtunën; gomari i Balamit; gostia e Baltazarit; e fut në gropën e luanëve; hedh gurin e parë; gjethe (fletë) fiku; gjithçka mbaroi; gjykimi i Solomonit; kulla e Babelit; është Babiloni; mollë e ndaluar; (u shit) për tridhjetë aspra; kolos me këmbë prej argjili; me kostumin e Adamit; mëkati vdekjeprurës; shëro veten, o mjek; neveria shkatërrimtare; pema e njohjes; puthja e Judës; u hap sytë të verbëve; toka e premtuar; si shën Thomai mosbesues ; udha e kryqit; zë në shkretëtirë; fali o zot, se nuk dinë ç'bëjnë etj.*

b) me prejardhje nga mitologjia, si: *pastroj ahuret (stallat) e Avgjisë; filli i Arianës; guri i Sizifit; kali i Trojës; kutia e Pandorës; mollë sherri; nyja gordiane; shpata e Damolkeut; thembra e Akilit; berberi i Midasit; kaloj Akerontin; bashka e artë; dhurata e danajve; fluturimi i Ikarit; frutat e Tantalit; fuçia e Diogjenit; i fundit i Mohikanëve; pëlhura e Penelopës; kalon midis Skillës dhe Karibdës; shiu i artë; shtrati i Prokrustit; zjarri i Prometeut etj.*

c) me burim nga historia, gjeografia

etj., si: *edhe ti, Brut; zbuloi Amerikën; fitore si e Pirros; veza e Kolombit; betimi i Hanibalit; e mban barutin të thatë; edukim Spartan; epoka e artë; Gjiri i Derrave; shkon në Kanosa; pas meje kiameti; ligj i pashkruar; te molla e kuqe; nata e Shën Bartolomeut; nyje gordiane; Hanibali është te porta; tryezë e rrrumbullakët; vija e Teodosit etj.*

ç) me burim nga letërsia, folklori etj., si: *furtunë në gotën e ujit; lufton me mullinjtë e erës; shumë zhurmë për asgjë; lamtumirë armë!; si dhelpra me rrushtë; fjalë, fjalë, fjalë; hija e Bankos; kalorës me fytyrë të vrosur; mban gjarprin në gj; llampa e Aladinit; mali polli një mi; lufton me mullinjtë e erës; pjesa e luanit; qilimi fluturues; rrobat e reja të mbretit; nuk turbullon ujë etj.*

d) me burim nga filozofia, politika etj., si: *gomari i Buridanit; arsye e mjaftueshme; unë di se nuk di asgjë; Akili nuk e arrin kurrë breshkën; dashuri platonike; dyshoj, pra jam; ironia sokratike; qëllimi justifikon mjetin; një vënd nën diell etj.*

e) me burim nga shkencat të tjera, si nga matematika, mjekësia, fizika etj.,: *enë komunikuese; i sjell në emërues të përbashkët; fushë e minuar; helmetat blu; balanca e farmacistit; mimoza e turpshme; me pikë e me presje; diplomacia e strucit; qendra e gravitetit (e rëndesës); rrip transmisioni; vrimë e zezë; e shumëzoh me zero; vë shenjën e barazimit; shkopi i dirigjentit; violinë e parë etj.*

ç) një pjesë e mirë e kalkeve frazeologjike kanë karakter thjesht gjuhësor⁵ dhe janë përkthyer nga gjuhët origjinare, si: *thyej akullin; fakt i kryer; ide*

Shprehjet e huazuara në gjuhën shqipe dhe hartimi i një fjalori për to

fikse; kartë e bardhë; ngjyra lokale; e vret me pambuk; vë pikat mbi "i"; lexoj midis rreshtave (radhëve); rreth vicioz; shpërthen një derë të hapur; hedh hije etj.

Huazimet⁶ frazeologjike, siç dihet, janë shprehje që përdoren të papërkthyer në gjuhën shqipe, pra që ruajnë të njëjtën përbërje fonetike me gjuhët origjinare.

Huazimet frazeologjike dhe shprehjet e tjera të papërkthyer janë marrë nga gjuhë të ndryshme, si:

a) latinishtja (të cilat përbëjnë dhe pjesën më të madhe të huazimeve në shqipe), si: *ab incunabulis; ad augusta per augusta; ad hoc; ad usum Delphini; advocatus diaboli; alter ego; alma mater; aperto libro; ars longa, vita brevis; audiatur et altera pars; aurea mediocritas; avis rara; bos in lingua; caput mortuum; caput mundi; carpe diem; casus belli; castigat ridendo mores; circulus vitiosus; cogito ergo sum; consummatum est; de lana caprina; de te fibula narratur; deus ex machina; divide et impera; dixi et animam (mean) salvavi; ecce homo; errare humanum est; exegi monumentum; ex nihilo nihil fit; extra nuros; fiat lux; flagrante delicto; fructus belli; fuit Troja; gutta cavat lapidem; hic sunt leones; homo homini lupus est; honoris causa; imperum in impero; incredibile dictum; in hoc signo vinces; in medias res; intra muros; in vino veritas; lapsus calami; lato sensu; magister dixit; manus manum lavat; mea culpa; mirabile dictum; modus vivendi; nec plus ultra; nil sub sole novum; nosce te ipsum; o tempora, o mores; pater patria; post festum; primus inter pares; punctum*

saliens; quod scripsi, scripsi; quo vadis?; spira, spera; summa cum laude; tabula rasa; urbi et orbi; etj.

b) frëngjishtja, si: *a la carte; a l'eau de rose; a livre ouvert; amour proper; après nous le deluge; a propos des bottes; a tout prix; ballon d'essai; belles letters; billet-doux; carte blanche; caveant consules; chair a canon; cherchez la femme; conseil du lion; couleur locale; danse macabre; e'lan vital; eminence grise; entre nous; fait accompli; fin de siecle; force majeure; homme d'etat; homme de letters; l'amor platonique; le roi est mort, vive le roi; letter morte; mot a mot; nolens, volens; Paris vaut bien le messe; tel pere, tel fils tj.*

c) anglishtja, si: *big bang; big brother; ever say never; fair play; fifty-fifty; five o'clock; happy end; kill with kindness; knock-down; mealting pot; much ado about nothing; poor Yorick; safety first; self-made-man; step by step; time is money; wait and see etj.*

ç) gjermanishtja, si: *aussprechen was ist; befehl ist befehl; Blitz Krieg; Blut und Eisen (Eisen und Blut); Grosen un Ganzen; Mehr Licht; Naht und Nebel; Shturm und Drang etj.*

d) italishtja, si: *colpo di stato; cuopri fuoco; dolce far niente; dulce in fundo; eppur si move; guarda i passa; pezzo grosso; salto mortale etj.*

e) greqishtja, si: *dhakrojen jelasomen; Eureka!; gnoti seauton; kai sy teknon etj.*

Prallë përdoren edhe shprehje të huazuara nga spanjishtja, portugalishtja etj.

Mjaft shprehje të tilla, siç u përmën-

dën më lart, në gjuhën shqipe përdoren edhe si kalke, edhe si huazime. Madje, mund të përdoret e njëjta shprehje brenda një konteksti në të dyja format. Kjo ndodh se është ndër e nevojshme nga autori për ta dhënë në shqip huazimin, duke e shpjeguar atë.

Ndër shprehjet që përdoren edhe si kalke, edhe si huazime mund të përmendim: *balonë prove (balon d'essai)*; *në kalendat greke (ad calendae graecae)*; *zaret u hodhën (alea jacta est)*; *mesi i artë (aurea mediocritas)*; *rreth vicioz (circulus vitiosus)*; *këtu është Rodi, këtu kërcë (hic Rhodus, hic salta)*; *o kohë, o moral (o tempora, omores)*; *zë në shkretëtirë (vox in deserto)* dhe shumë të tjera.

III. Penat më të fuqishme që shkruajnë në këto fusha të letrave, bëjnë edhe një punë krijuese gjuhësore në dy drejtime: krijojnë njësi të reja dhe përpunojnë stilistikisht mjetet që janë në gjuhë. Edhe kalket, huazimet dhe shprehjet e tjera përpunohen nga ana e ndërtimit dhe e kuptimit, përsosen në përshtatje me llojin e shkrimit a të problemit që trajtohet. Gjithashtu, ato u nënshtrohen mjaft ndryshimeve me karakter ndërtimor e fonetik, sipas gjuhës kur përdoren. Kësisoj, shprehjet e huazuara pësojnë risi të rëndësishme, mjaft syresh “çngurosen” dhe dalin në forma të reja; hyjnë në lidhje të ndryshme leksikore, “marrin frymë” më gjerë duke u vendosur në situata të reja ligjërimore dhe në kontekste të

reja fjalësh.

Cilat janë disa nga risitë që vihen re në përdorimin e shprehjeve të huazuara në gjuhën shqipe?

a) “Rrudhja” e strukturës së kalkeve frazeologjike është një dukuri e njohur dhe e përmendur nga autorë të ndryshëm. Rënia e një a e dy gjymtyrëve nga përbërja e shprehjeve të tilla sjell ndryshime të karakterit strukturor, duke dhënë mundësi të shumta që strukturat e mbetura të futen në lidhje të reja leksiko-sintaksore. Në këtë mënyrë, trajta e rrëgjuar, sikurse trajta e plotë, e ruan kuptimin leksikor dhe ngjyrimin emocional. Për shembull: *fjalët i merr era, e shkruara mbetet nga latinishtja verba volant, scripta manent del në trajtën fjalët i merr era (verba volant), në kuptimin “s’kanë vlerë fjalët po qe se nuk shoqërohen me vepra; fjalët harrohen shpejt”*. Por gjen të përdorur dhe vetëm pjesën e dytë e *shkruara mbetet (scripta manent)*.

Ndonjëherë rrudhja e këtyre njësieve çon në ndërtime të tilla, të cilat, duke u përdorur gjatë në formë të reduktuar, fitojnë përdorim të pavarur dhe kufizojnë përdorimin e kalkeve frazeologjike dhe të shprehjeve të tjera burimore. Madje, ndonjë formim i tillë e shmang plotësisht nga përdorimi formën e plotë, siç është shprehja *ana tjetër e medaljes* nga frëngjishtja *le revers de la medaille*, e cila duhet të ketë ardhur nga reduktimi i trajtës së plotë *çdo medalje ka dhe anën e saj të kundërt*.

b) Mjaft kalke frazeologjike nuk

përdoren me një përbërje leksikore të vetme, por ndryshojnë duke patur si gjymtyrë fjalë të afërta nga kuptimi. Dallohet kështu dukuria e variacionit (e ndryshueshmërisë) leksikor. Kjo lidhet me mundësitë sinonimike që ka shqipja për të kalkuar shprehjet e qëndrueshme nga gjuhë të tjera.

Ndryshueshmëria leksikore përbën një risi dhe, njëherësh, një tipar të rëndësishëm të përdorimit të kalkeve frazeologjike në gjuhën shqipe, për shembull: *ahuret (stallat) e Avgjisë*; *çaj (thyej) akullin; arka (varka, barka) e Noes; biri (djali) plangprishës; shpëthen (thyen) një derë të hapur; rrufe në qiell të kaltër (rufe në të kthjellët; rufe në një ditë me diell)* etj.

c) Kalket dhe huazimet frazeologjike dalin në lidhje të shumta leksiko-sintaksore, në mikrokontekste të ngushta ose në thënie të ndryshme. Edhe në këtë aspekt kemi risi me vlera të veçanta, që lidhen me përdorimin e frazeologjisë në ligjërime. Studimi i këtyre lidhjeve leksiko-sintaksore ose i fushës semantiko-sintaksore të kalkeve dhe huazimeve, nuk është thjesht një çështje e formës, sepse kuptimi i tyre dhe vlerat stilistiko-emocioniese zbulohen më mirë në lidhje me fjalë të tjera në ligjërime.

Kalket dhe huazimet frazeologjike, duke zgjeruar rrethin e lidhjeve leksikore me fjalë të tjera, zbulojnë deri në fund të gjitha vlerat kuptimore që kanë ose që mund t'i fitojnë në ligjërime dhe shkruar, çka mund ta konkretizojmë

me disa shembuj:

E përdor-

E bën-

E cilëson-

Është-

E quan-

E fut- KALI I TROJËS; KALIN E TROJËS; KALË TROJE

Hyn si-

Luan rolin e-

Shpreson me anën e-

E pranon si-

Mbetet si-

E ka si-

Siç vihet re, vetëm kjo shprehje në gjuhën shqipe përbëhet nga 13 fjalë të rrethit leksikor, në varësi të të cilave ndryshon dhe formën e përdorimit.

Rrethi i lidhjeve mund të zgjerohet ose të ngushtohet në varësi të kuptimit leksikor dhe të vlerave që mbart shprehja e huazuar, si:

Shtyj-

Lë-

Bëj-NË (PËR NË) KALENDAT

GREKE (KALENDAT GREKE)

Realizoj-

Prodhoj-

Gjen-

Është-

Arrin -(NJË) MODUS VIVENDI

Krijon-

Shërben-

U soll-

E bëri-

E paraqiti - FAIT ACCOMPLI

E vë para-

Kalke me lidhje të gjera leksikore e sintaksore janë edhe *kolonë e pestë* “armik i fshehtë; njerëz që në fshehtësi zhvillojnë veprimtari kundër dikujt e diçkaje tjetër”; *rreth vicioz* “gjendje pa rrugëdalje; pozitë e vështirë”; *shkopi i dirigjentit* “mjet a mënyrë për të bindur a nënshtruar dikë a diçka” etj.

c) Një tjetër dukuri në këtë fushë është aktualizimi i shprehjeve të huazuara, domethënë, ndërfitja e fjalëve të tjera në strukturën e tyre për t'i lidhur më ngushtë me situatën konkrete të ligjërimit, me ngjarjet, personazhet a çështjen për të cilën shkruhet, me kohën a vendin për çka bëhet fjalë në kontekstin e dhënë. Me fjalë të tjera, përmes aktualizimit synohet të vendosen lidhje të ngushta mes kuptimit të kalkeve frazeologjike dhe situatës ligjërimore.

Shembujt tregojnë se aktualizimi mund të bëhet në të gjitha pozicionet e gjymtyrëve, pra aktualizuesit vihen para, në mes dhe pas gjymtyrëve të shprehjes së huazuar, për shembull: akulli i *heshtjes* u thye; kolona e *pestë shqiptare*; turbullon ujërat e *kulluara*; të gjitha rrugët të çojnë në *zgjedhje* etj.

Në fushën e kalkeve mund të ndodhin dhe aktualizime gramatikore, duke ndryshuar e zgjeruar paradigmen e gjymtyrëve shënuese (folje, emra), përkundër tiparit të qëndrueshmërisë së tyre, siç ndodh rëndom tek idiomat.

Bibliografia

1. Term që shënon fjalë a shprehje të përkthyer sipas ndërtimit në gjuhën dhënëse. Kalket frazeologjike mund të përkufizohen si ndërtime dy-trigjymtyrëshe, me kuptim të figurshëm e të përgjithësuar, të ngurosura gjatë praktikës së përdorimit në ligjërimit etj.
2. Term që shënon shprehje të përdorura në gjuhën shqipe pa përkthim. Pra, huazimet e plota nuk i janë nënshtruar asimilimit të shqipes, ato shkruhen në gjuhën e huaj dhe shqiptohen po ashtu.
3. Pas disa vitesh pune, më 1995 është botuar një pjesë e materialit me titullin “*Filli i Arianës*” (Shtypshkronja Kotti, Korçë), ku përmbledhen rreth 600 kalke e huazime frazeologjike.
4. *Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe* (Tiranë, 1999) i prof. Jani Thomait na ka shërbyer edhe si lëndë burimore për mjaft kalke frazeologjike, që nuk i kemi hasur në literaturën e vjelë.
6. Në fjalor nuk janë përfshirë kalke të tilla, si: *më bën përshtypje*; *marr pjesë*; *ka vend*; *marr masa* etj., që shpesh nuk ndjehen si të tilla në gjuhën shqipe.
7. Termi huazim del në rusisht: *ЗАИМСТВОВАНИЕ*; frëngj. *emprunt*; angl. *borrowing*.